

URDHËR
Nr. 529, datë 15.9.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të nenit 14, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”; si dhe të udhëzimit nr. 22, datë 10.7.2013, të ministrit të Financave, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave, ‘Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit’”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për trajtimin dhe nënshkrimin e urdhrave për shërbimet jashtë vendit, për punonjësit e aparatit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të institucioneve të varësisë, Sekretarit të Përgjithshëm.
 2. Delegimi i kompetencave do të jetë në fuqi deri në një urdhër të dytë.
 3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, nëpunësit e aparatit dhe institucioneve të varësisë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
 4. Urdhri nr. 51, datë 14.2.2022, “Për delegimin e kompetencave”, shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj